

Të informohemi rreth K2

Çfarë është K2?

K2 është një drogë sintetike. Ajo përbëhet nga materiale të thara e të grira, të spërkatura me një përbërje kimike.

Ajo nuk është kanabis (bar) por shpesh shitet si një “alternativë e THC-së”.

Emërtime të tjera të K2

Spice, Green Giant, Potpourri, Bizarro, Geeked Up, Smacked, AK-4, RedX Dawn, Paradise, Demon, Black Magic, Spike, Mr. Nice Guy, Ninja, Zohai, Dream, Genie, Sence, Smoke, Skunk, Serenity, Yucatan, Fire, Skooby Snax dhe Crazy Clown.

Efektet dhe rreziqet e K2

K2 mund t'ju bëjë të ndiheni të lumtur ose të relaksuar, por gjithashtu mund t'ju bëjë të ndiheni shumë të distancuar ose të shkëputur nga bota që ju rrethon. Ajo mund të shkaktojë gjithashtu:

- | | |
|--|--------------------------------|
| ■ Ankth | ■ Të përziera |
| ■ Hutim | ■ Të vjella |
| ■ Paranojë ose halucinacione | ■ Rrahje të shpeshta të zemrës |
| ■ Sjellje të dhunshme | ■ Insuficiencë renale |
| ■ Përgjumje | ■ Konvulsione |
| ■ Gjendje të fikëti ose pandërgjegjshmërie | ■ Mendime për vetëvrasje |

Kujdes ...


- K2 mund të ndryshojë nga njëri prodhim në tjetrin ose në varësi të markave të ndryshme
- Njerëzit kanë përjetuar efekte më të forta kur e kanë përzier K2 me substanca të tjera (si p.sh. alkool apo fenciklidinë (PCP))
- Përdorimi dhe ndalimi i përdorimit mund të shkaktojnë simptoma të tilla si gjendje pandërgjegjshmërie, mungesë oreksi, dhimbje stomaku, të vjella etj.



Imazhet nga Administrata e Zbatimit Ligjor mbi Substancat Narkotike (DEA)

Të informohemi rreth K2

Mënyrat e reduktimit të rrezikut kur përdorni K2



Shmangni përzierjen e K2 me substanca të tjera



Përdoreni afër orareve kur ushqeheni nëse është e mundur
Përpikuni të konsumoni ushqim para dhe gjatë përdorimit të K2



Nisni me sasi të ulëta, vazhdoni gradualisht
Shembull: thitheni vetëm një herë dhe prisni derisa të shikoni ndikimin që do të ketë te ju para se të vazhdoni ta konsumoni



Konsultohuni me një ofrues të kujdesit shëndetësor parësor apo ofrues të shërbimeve të shëndetit mendor lidhur me barnat për menaxhimin e nevojave të tjera



Qëndroni të hidratuar!
Pini shumë ujë para dhe gjatë përdorimit të K2




Nëse jeni duke e përdorur K2 për trajtimin e dhimbjeve, kërkoni të konsultoheni me një ofrues të kujdesit shëndetësor për menaxhimin e dhimbjeve



Pasi të keni tymosur jashtë, futuni në një ambient të brendshëm të sigurt me njerëz të tjerë përreth



Konsultohuni me një ofrues të kujdesit shëndetësor për dhimbjet e stomakut, të përzierat ose të vjellat (veçanërisht në rastet e ndalimit të përdorimit)



Shmangni përdorimin kur jeni vetëm ose pranë njerëzve që ju nervozojnë
Përdoreni me dikë që keni besim ose telefononi linjën e ndihmës Never Use Alone: (800) 484-3731



Zhvilloni një plan sigurie për të reduktuar rrezikun
Për mbështetje, kontaktoni në adresën
harmreduction@dss.nyc.gov